



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 maj 2014
Nr.ref.:RK579/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI191/13

Parashtrues

Fejzullah Fejzullahu

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
PN. nr. 624/2012, të 11 tetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fejzullah Fejzullahu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Fushë-Kosovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 624/2012, të 11 tetorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 624/2012, të 11 tetorit 2013 dhe të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nr. 316/13, të 26 korrikut 2013, si aktvendime, të cilat nuk janë të bazuara në fakte. Parashtruesi i kërkesës nuk i saktëson nenet e Kushtetutës, të cilat janë shkelur, por vetëm pretendon se me aktvendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat njerëzore dhe materiale.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 6 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI191/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI191/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 23 janar 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës për regjistrimin e kërkesës me nr. KI191/13.
8. Më 25 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues paraqiti rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 3 shkurt 2009, Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: PPK), me propozimkuzën (PP. nr. 364-5/2009), e akuzoi parashtruesin e kërkesës se prej një date të pacaktuar e deri më 17 tetor 2008, kishte vjedhur energjinë elektrike në lokal, i cili ishte në pronësi të tij, dhe në këtë mënyrë kishte dëmtuar Korporatën Energjetike të Kosovës.
10. Më 11 maj 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, duke vendosur sipas propozimkuzës së PPK-së, nxori Aktgjykimin (P. nr. 233/09), me të cilin e shpalli parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale të vjedhjes dhe e dënoi me gjobë. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata Komunale theksoi:

“Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës dhe konkretisht: procesverbalin nr. 199758 të datës 17.10.2008, fotodokumentacioni dhe fatura nr. DPR08HP071171, e dt. 18.12.2008, si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, andaj gjykata konstaton se këto prova janë bindëse, të bazuara në ligj dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe të njëjtin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

11. Më 16 qershor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, pasi që Aktgjykimi P. nr. 233/09, i 11 majit 2010, mori formën e prerë, nxori Aktvendimin E. nr. 1140/2010, me të cilin lejohet përmbartimi ndaj parashtruesit dhe parashtruesi i kërkesës detyrohet që në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të aktvendimit ta paguajë dënimin me gjobë, përndryshe do të shndërrohet në dënim me burgim. Kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë ankese brenda shtatë (7) ditësh nga data e marrjes së vendimit.
12. Më 10 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kundërshtim ndaj Aktvendimit E. nr. 1140/2010, të 16 qershorit 2010, duke e kundërshtuar atë në tërësi.
13. Më 19 shkurt 2013, për shkak të obligimeve të papaguara nga aktvendimi për përmbartim i Gjykatës Komunale, parashtruesi është marrë me forcë për të mbajtur dënimin me burgim nga Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 1140/2010, të 11 majit 2010.
14. Më 30 korrik 2013, me Aktvendimin KP. nr. 316/13, Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur përkitazi me kërkesën e parashtruesit, kishte refuzuar si të pabazë kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale, të përfunduar me Aktgjykimin P. nr. 233/09, të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
15. Në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Themelore KP. nr. 316/13, thuhet:

“Duke pasur parasysh këto fakte dhe provat në të cilat është bazuar vendimi i shkallës së parë sipas vlerësimit të kolegjit penal pretendimet e të gjykuarit rezulton se nuk janë prova të reja sipas nenit 423 të KPP-së. Deklarimet se ky vendim është absurd, se është tendencioz dhe se gjyqtari e ka detyruar që ta bëjë pagesën e dënimin si dhe provat e bashkëngjitura-artikulli në gazetën ‘Bota Sot’ dhe disa fatura të vitit 2005, 2006 në emër të tij dhe një raport ‘Transaksionet e konsumatorit’ për periudhën 01.01.2005 deri më dt. 31.12.2010 i cili është për atë lokal-adresa e njëjtë por që nuk është në emër të tij, nuk janë me ndikim për rishikimin e procedurës penale”.

16. Më 11 tetor 2013, me Aktvendimin PN. nr. 624/2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 316/13. Në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, theksohet:

“Me qenë se kërkesa për rishikimin e procedurës penale, e as ankesa e ushtruar kundër aktvendimit mbi refuzimin e kërkesës, i dënuari nuk ka

afruar ndonjë prove të re e cila vet ose së bashku me provat e më përparshme ka të ngjarë të arsyetoj pafajësinë e të dënuarit lidhur me veprën e kryer penale, kolegji i kësaj gjykate duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Propozimin e Prokurorisë së Apelit, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e KPPK-së me rastin e refuzimit të kërkesës së të dënuarit, pasi që nuk ekzistojnë shkaqe ligjore për rishikimin e procedurës penale, e të cilin qëndrim e pranon edhe kjo gjykatë prandaj këto dhe ish-in arsyet që ankesa e të dënuarit Fejzullah Fejzullahu u refuzua si e pabazuar”.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se autoritetet gjyqësore, respektivisht Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori një vendim arbitrar duke e shpallur atë fajtor për veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike, pa marrë parasysh gjendjen e fakteve dhe provave.

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon që:

“Kërkoj të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nr. 316/13, të datës 26.07.2013 si i pabazë dhe jo i bazuar në fakte: -Si mund të dënohem unë pas ca viteve, gjegjësisht pas 7 viteve pa u pa si dëshmi se shitblerja është bërë në vitin 2006 me të gjitha obligimet e kryera nga ana ime (kont. e vërtetuar në gjykatë)”.

19. Parashtruesi i kërkesës më tej i propozon dhe kërkon nga Gjykata:

“Në bazë të gjendjes faktike juridike, provave të paraqitura dhe të argumentuara, si dhe në bazë të padisë së gabuar ndaj meje, sepse padia është dashur të bëhet në emër të blerësit e jo ndaj meje, në bazë të malltretimeve fizike, njerëzore dhe materiale, propozoj dhe kërkoj nga gjykata që:

- të analizoj në mënyrën më serioze tërë materialin që po e bashkangjes,*
- të anuloj aktvendimet e mëparshme dhe:*
- të me liroj nga padia penale,*
- të kompenzohet dënimi i paguar me të gjitha shpenzimet gjyqësore, shpenzimet për avokatin dhe shpenzimet tjera materiale-morale”.*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Për më tepër, rregulli 36 (1) a), b) dhe c) i Rregullores së punës parasheh që:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar”.

23. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka plotësuar afatin e përcaktuar prej katër (4) muajsh, duke llogaritur nga dita kur i është dorëzuar aktvendimi i Gjykatës së Apelit. Në këtë rast, vendimi i fundit për rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN. nr. 624/2013, i 11 tetorit 2013. Si rezultat i kësaj, parashtruesi ka treguar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në përputhje me ligjet në fuqi. Ai në mënyrë specifike e konteston Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, si akte të autoriteteve publike, ai në mënyrë të qartë e ka deklaruar zgjidhjen e kërkuar ligjore, dhe se ka dorëzuar vendime të ndryshme dhe informata dhe dokumente të tjera mbështetëse.

24. Gjykata Kushtetuese vëren më tej se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë pretendim në baza kushtetuese në Gjykatën Themelore dhe atë të Apelit, qoftë në mënyrë implicite ose në substancë, me të cilin do të ngrinte shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi në kërkesën e tij të dorëzuar i bashkëngjiti Gjykatës kontratën e shitblerjes, të cilën nuk ua kishte bashkëngjitur provave dhe dokumenteve në gjykatat e rregullta në Kosovë. Arsyetimi i Aktvendimit PN. nr. 624/2013, të Gjykatës së Apelit është si në vijim:

“I dënuari nuk ka paraqitur fakte apo prova në lidhje me këtë, siç është kontratën mbi shitblerjen e cila në kuptim të nenit 423 par 1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës do të ishte vlerësuar si provë e re, dhe do të ishte bazë ligjore nga neni 423 të KPPK për lejimin e rishikimit të procedurës penale, dhe e cila provë kishte mund të vë në dyshim gjendjen faktike të konstatuar me aktgjykimin e urdhrin ndëshkimor me të cilin i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje nga neni 252 par.2 të KPK-së”.

25. Në praktikë, asgjë nuk e ka penguar parashtruesin që të ankohej në Gjykatën Themelore dhe të Apelit kundër shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut si dhe të paraqesë kontratën e shitblerjes, e cila do të vlerësohej si dëshmi e re. Nëse këto gjykata do ta kishin marrë parasysh shkeljen dhe provat e reja dhe nëse do ta korigjonin të njëjtën, e tëra do të përfundonte këtu; në qoftë se gjykatat nuk do të korigjonin shkeljen apo nëse nuk do të merrnin parasysh provat e reja, parashtruesi do të plotësonte kushtin për shterimin e të gjitha mjeteve juridike në kuptimin që këtyre gjykatave u është dhënë mundësia për të korigjuar shkeljen e pretenduar.
26. Në çdo rast, Gjykata Kushtetuese konstaton se faktet e rastit nuk lejojnë përfundim bindës se bazat e ankesës së "një zbatimi të gabuar të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike" të pretenduara në Gjykatën e Apelit e plotësojnë testin e Gjykatës Evropiane. Prandaj, nuk është e nevojshme që në këto rrethana, çështja të shqyrtohet më tej.
27. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte argumentuar dhe mbështetur me prova shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit.
28. Në të vërtetë, pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave kushtetuese nuk përbëjnë arsye të mjaftueshme *prima facie* për të ngritur një rast në Gjykatë; pakënaqësia e parashtruesit me vendimin e gjykatave të rregullta nuk përbën një bazë kushtetuese për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese.
29. Për më tepër, Gjykata vëren se, në mënyrë që një rast *prima facie* të plotësojë kriteret për pranueshmëri të kërkesës, parashtruesi duhet të provojë se procedurat në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme, të shikuara në tërësinë e tyre, nuk ishin mbajtur në atë mënyrë në të cilën parashtruesi i kërkesës do të kishte pasur një gjykim të drejtë ose që shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese mund të ishin kryer nga ana e gjykatave të rregullta gjatë gjykimit.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, sipas të cilit, "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".
31. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
32. Prandaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, në këtë rast, kur shqyrtohen vendimet e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

33. Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Themelore dhe të Apelit ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
34. Si përmbledhje, Gjykata arrin në përfundim se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e mbajtur më 25 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'ua kumtojë këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetues



Prof. dr. Enver Hasani